

AKT THEMELIMI

Sot ne dt.07 Qershor 2020 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

ARTAN MYRTAJ, i biri i Arap(it) i datelindjes 02-09-1976, i lindur ne Vlore,dhe banues ne Fshatin Trevllazer, Novosel, Vlore, Shqiperi, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes per jashte shtetit me Nr.BD7386363 ,leshuar nga MB Tirane ne date 07-09-2017,

DAUD FAROOQ, i biri i Ghulam Mohammed i datelindjes 16-06-1969, i lindur ne Londer-Mbreteria e Bashkuar e Britanise se Madhe dhe banues ne 35 Melbourne Road Ilford, IG1 4LF, Mbreteria E Bashkuar e Britanise se Madhe shtetas britanik, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes per jashte shtetit me Nr.536793877 ,leshuar ne date 08-06-2016,

ROBERT ANDREW SARGENT, i biri i Eric Joseph i datelindjes 20-02-1963, i lindur ne Dorking-Mbreteria e Bashkuar e Britanise se Madhe dhe banues ne 28 Arundel Gardens, Londer, W112LB, Mbreteria E Bashkuar e Britanise se Madhe shtetas britanik, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes per jashte shtetit me Nr.551525810 ,leshuar ne date 20-03-2018,

te cilet me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **Mansa Group Shareholding** shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezqatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **Mansa Group Shareholding** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **Mansa Group Shareholding** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **Mansa Group Shareholding** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Lagj.Nr.1,Rruga "Onhezmi", Godina nr.92 afer Gjykates, Sarande.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakeve.



Neni 4

Objekti i veprimtarise

- Investime ne fushen e energjitikes, investime financiare te ndryshme, turistike, eksport dhe import.
- Projektim dhe ndertim te objekteve civile, industriale, bujqesore, turistike dhe ekonomike, rikonstruksione objektesh, ndertim sillosa, kullauji, rruge, ura, vepra arti, ndertim ujesjellesa, kanalizime, kanale e impjante vaditje, ndertim digash punime karpentjenerie prej druri dhe metalike, perforcime themeli dhe izolime mbi dhe nentokesore, bojatisje ,hidroizolim, punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbishtresash rrugore
- Importin , eksportin dhe tregetin me shumice dhe pakice te artikujve te ndyshem industriale , ushqimore , produkteve te ndryshme bujqesore , blegtorale e fruta perime , prodhimeve te detit , pije freskuese , te miellit e nenprodukteve te tij , te konfeksioneve e veshmbathjeve , pajisje elektroshtepiake , kompjutera dhe pjeset e tjera te tyre , produkte higjenosanitare , hidraulike , prodhime qeramike artizanati, duralumini , mekanike te lendes drusore te perpunuar dhe te paperpunuar, lekures e nenprodukteve te saj , mobiljeve dhe materialeve te lendeve te para te te gjitha llojeve , materiale dhe lendeve te ndertimit , pllakat e llojeve dhe dimensioneve te ndryshme , materialeve plastike e nenprodukteve te tyre.
- Transport kombetar dhe nderkombetar tokesor te udhetareve, bagazheve dhe mallrave.
- Hapje farbrikash , ndertime hecesh , prodhim dhe shitje energjie, hapje spitalesh, hapje te depove farmaceutike etj.
- Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajteshme dhe te paluajteshme, pjesemarrje me kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 300,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 300.000 leke i perbere nga 3 kuota dhe zoterohet nga ortaket e shoqerise si me poshte :


1. Ortaku Themelues: **ARTAN MYRTAJ**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 Leke, e cila perfaqeson 33.34 % te kapitalit te shoqerise,
2. Ortaku Themelues: **DAUD FAROOQ**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 Leke, e cila perfaqeson 33.33 % te kapitalit te shoqerise.
3. Ortaku Themelues: **ROBERT ANDREW SARGENT**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 Leke, e cila perfaqeson 33.33 % te kapitalit te shoqerise

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar **300.000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **300.000 Leke nuk** eshte paguar nga asnje prej ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;



Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit,te ortakeve pjesmarres,per ndryshimin e statutit,zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,shperndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres,per çeshtje te tjera si:emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,te likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar,percaktimin e shperblimeve,perfaqesimin e shoqerise ne gjykate.Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR.

Neni 10

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga tre administrator te perbashket.

Administratoret e shoqerise jane ortaket e saj **Z.ARTAN MYRTAJ, Z.DAUD FAROOQ, Z.ROBERT ANDREW SARGENT** me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, te cilet kane te gjitha kompetencat per te kryer bashkarisht te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Neni 11

Kompetencat

Administratoret kane të gjitha kompetencat për të vepruar se bashku në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratoret angazhojne shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratoret ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet

ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene

a.Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

b.Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c.Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare **Mansa Group Shareholding** shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

DAUD GAROQ



Artan Myrtaj



ROBERT SARCENT
R. Sarcent.